



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:051149
Datë: 31.10.2022
Numri i dokumentit: 03589929

C.nr.291/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim Balaj me zyrtaren ligjore Albana Curri, në çështjen kontestimore të paditësit M.Gj nga fshati ..., Komuna Gjakovë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, DKA, për kompensimin e ushqimit gjatë punës dhe shpenzimeve të transportit, vlera e kontestit 1,584.60 (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me 19 tetor 2022, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të te paditurës, me 31 tetor 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.Gj nga fshati ..., Komuna Gjakovë dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - DKA, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit – shujtave për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 491 ditë pune, për periudhën kohore 01.04.2018 – 31.08.2021, të ia paguajë shumën prej 982,00 (nëntëqind e tetëdhjetë e dy euro), si dhe për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë, për periudhën kohore 01.04.2018 – 31.08.2021, të ia paguajë shumën prej 558,60 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë euro e gjashtëdhjetë cent), e në shumë të përgjithshme prej 1.584,60 (një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 15.03.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 629,60 (gjashtëqind e njëzetë e nëntë euro e gjashtëdhjetë cent), në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Shqyrtimi në këtë çështje kontestimore është mbajtur në mungesë të te paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 423 paragrafi 4, i Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme LPK).

Paditësi, në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 15.03.2021 përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar se i njëjti është i punësuar tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës i Menaxhmentit dhe Informatikës. Ka shtuar se në bazë të nenit 36 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 11.04.2014 dhe në bazë të nenit 35 paragrafi 5 dhe paragrafi 7 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.07.2017, është e obliguar që punëtorëve të arsimit, përkatësisht këtu paditësit të i kompensojë ushqimin gjatë punës dhe shpenzimet për udhëtim, përkatësisht 70% të shpenzimeve të udhëtimit për destinacionin nga vendbanimi i paditësit deri në vendin e tij të punës. E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Kontratat e sipër cekura, nuk ka përmbushur obligimet e caktuara që rrjedhin nga të njëjtat, kështu që për këtë arsye paditësi ka parashtruar padi – kërkesëpadi për realizimin e të drejtës së tij subjektive.

I autorizuari i paditëses përgjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet tërësi pranë padisë, deklarimeve gjatë shqyrtimeve në këtë çështje kontestimore dhe në parashtrësën lidhur me precizimin e kërkesëpadisë të datës 29.09.2022. Ka shtuar se në këtë çështje kontestimore pas administrimit të provave, është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie të rregullt të punës tek e paditura dhe në bazë të vërtetimeve të shkollave ku ai punon, është vërtetuar prania e tij në punë. Në bazë të vërtetimit të Shoqatës së Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë, është vërtetuar lartësia e kërkesës, ndërsa sa i përket shpenzimeve të udhëtimit dhe gjitha këto prova së bashku me ekspertizën financiare të ekspertit N.N në mënyrë të pakontestueshme duke u ndërlidhur me Kontratën Kolektive të Arsimit, është vërtetuar kërkesëpadija e precizuar e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadinë e precizuar të e aprovojë në tërësi të si bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë shumën prej 20,00 euro e cila shumë referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shumën prej 104,00 euro e cila shumë i referohet përpilimit të padisë, për përfaqësim në tre seanca (secila 135,20 euro) dhe shumën prej 100,00 euro e cila shumë i referohet përpilimit të ekspertizës financiare, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 629.60 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 04.08.2021 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 11.08.2021 (siç vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo e njëjta deri në momentin e përpilimit të këtij aktgjykimi, nuk ka parashtruar fare përgjigje në padi, përkundër obligimit ligjor.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt, me ç'rast pas analizimit të fakteve juridike relevante të kësaj çështjeje, vlerësimit veç e veç të provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadija e precizuar e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua në tërësi.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: kontratën e punës, me nr. të prot. 126/18, datë 05.11.2018, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës DKA; kontratën e punës, me nr. të prot. 94/19, datë 01.09.2019, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës DKA; kontratën e punës, me nr. të prot. 16/20, datë 01.09.2020, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës DKA; vërtetimin e lëshuar nga SHTU në Gjakovë (pa datë të lëshimit), i lëshuar me kërkesën e paditësit M.Gj; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, nr. 60/21, datë 31.05.2021, i lëshuar nga SHFMU “Fehmi Agani” në Gjakovë; Vërtetim për ditët e prezencës në punë, nr. 106/21, i lëshuar nga SHFMU “Pjetër Muqaj” në Gjakovë; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, datë 20.05.2021, i lëshuar nga SHFMU “Anton Qeta” Dol – Gjakovë; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, nr. 05/21, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Gjakovë – Osek Hylë; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, nr. 26/21, i lëshuar nga SHFMU “Engjëll Gjoni” në Gjakovë – Novosellë e Ulët; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, nr. 41/021, i lëshuar nga SHFMU “Fan Noli” në Gjakovë – Dujakë; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, nr. 61, i lëshuar nga SHFMU “Shtjefën Kurti” në Gjakovë – Novosellë e Epërme; vërtetimin për ditët e prezencës në punë, nr. 825/21 i lëshuar nga SHFMU “Ukshin Miftari” në Gjakovë – Skivjan; si dhe ekspertizën financiare e përpiluar nga eksperti i licencuar i gjykatës N.N, me datë 18.08.2022

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga kontrata e punës, me nr. të prot. 126/18, datë 05.11.2018, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë, vërtetohet se paditësi në cilësinë e mësimitdhënësit në lëndën - gjuhë gjermane, ka punuar në shkollën “Fehmi Agani” – Gjakovë dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 05.11.2018 – 31.08.2019

Nga kontrata e punës, me nr. të prot. 94/19, datë 01.09.2019, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë, vërtetohet se paditësi në cilësinë e mësimitdhënësit në lëndën - gjuhë gjermane, ka punuar në shkollat si në vijim: 1. “Shtjefën Kurti” - Novosellë e Epërme, 2. “Engjëll Gjoni” - Novosellë e Ulët, 3. “Ukshin Miftari” – Skivjan, 4. “Fan Noli” – Dujakë, 5. “Isa Boletini” – Osek Hilë dhe 6. “Anton Çeta” – Dol dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2019 – 31.08.2020

Nga kontrata e punës, me nr. të prot. 16/20, datë 01.09.2020, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë, vërtetohet se paditësi në cilësinë e mësimitdhënësit në lëndën - gjuhë gjermane, ka punuar në shkollat si në vijim: 1. “Shtjefën Kurti” - Novosellë e Epërme, 2. “Fan Noli” – Dujakë, 3. “Engjëll Gjoni” - Novosellë e Ulët, 4. “Anton Çeta” – Dol dhe 5. “Isa Boletini” – Osek Hilë dhe kohëzgjatja e kontratës së punës është 01.09.2020 – 31.08.2021

Nga vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë (pa datë të lëshimit), i lëshuar me kërkesën e paditësit M.Gj, vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në këto relacione si në vijim: 1. ... – Gjakovë – 0.50 euro; 2. Gjakovë – Dujakë – 1,00 euro; 3. Gjakovë – Skivjan – 0,50 euro; 4. Gjakovë – Dol – 0,50 euro; 5. Gjakovë – Novosellë e Epërme – 1,00 euro dhe 6. Gjakovë – Novosellë e Ulët – 1,00 euro.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 60/21, datë 31.05.2021, i lëshuar nga SHFMU “Fehmi Agani” në Gjakovë, vërtetohet se këtu paditësi në vitin shkollor 2018/2019, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 27 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 106/21, i lëshuar nga SHFMU “Pjetër Muqaj” në Gjakovë, vërtetohet se këtu paditësi në vitin shkollor 2018/2019, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 31 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, datë 20.05.2021, i lëshuar nga SHFMU “Anton Qeta” Dol – Gjakovë, vërtetohet se këtu paditësi nga viti shkollor 2018/2019 – 2020/2021, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 80 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 05/21, i lëshuar nga SHFMU “Isa Boletini” në Gjakovë – Osek Hylë, vërtetohet se këtu paditësi nga viti shkollor 2018/2019 – 2020/2021, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 83 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 26/21, i lëshuar nga SHFMU “Engjëll Gjoni” në Gjakovë – Novosellë e Ulët, vërtetohet se këtu paditësi nga viti shkollor 2019/2020 – 2020/2021, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 52 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 41/021, i lëshuar nga SHFMU “Fan Noli” në Gjakovë – Dujakë, vërtetohet se këtu paditësi nga viti shkollor 2019/2020 – 2020/2021, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 83 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 61, i lëshuar nga SHFMU “Shtjefën Kurti” në Gjakovë – Novosellë e Epërme, vërtetohet se këtu paditësi nga viti shkollor 2019/2020 – 2020/2021, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 52 ditë pune.

Nga vërtetimi për ditët e prezencës në punë, nr. 825/21 i lëshuar nga SHFMU “Ukshin Miftari” në Gjakovë – Skivjan, vërtetohet se këtu paditësi nga viti shkollor 2018/2019 – 2019/2020, në institucionin e lartcekur ka vijuar gjithsejtë 55 ditë pune.

Nga ekspertiza financiare e përpiluar nga eksperti i licencuar i gjykatës N.N - ecc. i diplomuar, me datë 18.08.2022, i cili duke u bazuar në të gjitha provat valide të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka ardhur deri tek përfundimi se paditësi në raport me kërkesën e kompensimit të shujtës ditore, bazuar në shkollat përkatëse ka vijuar 491 ditë pune, ashtu që të njëjtit për këtë kriter i takon shuma në lartësi prej 982,00 euro. Sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të transportit dhe duke u bazuar në vërtetimin e Shoqatës së transportit të udhëtarëve të njëjtit për këtë kriter i takon shuma në lartësi prej 798,00 euro, përkatësisht shuma e përgjithshme në raport me dy kërkesat e lartcekura, është në lartësi prej 1.584,60 euro, ashtu sikurse i autorizuari i paditësit në këtë lartësi e ka precizuar kërkesëpadinë për këtë kriter të kompensimit. Eksperti në fjalë ekspertizën e tij e ka përpiluar në mënyrë profesionale, ashtu që gjykata të njëjtës ia fali besimin e plotë. Për më tepër të paditurës i është proceduar kjo ekspertizë me kohë, siç

vërtetohet nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës dhe e njëjta nuk ka dhënë vërejtje me shkrim, çka rezulton se është pajtuar me përmbajtjen e kësaj ekspertize.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”* si dhe duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale, meqenëse nuk ka parashtruar përgjigje në padi), faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku ka punuar këtu paditësi), si dhe faktin se nga vërtetimet e lartcituara, për periudhën kohore të kërkuar nga pala paditëse, rezulton se paditësi ka punuar në vendin e caktuar të punës për 491 ditë ($491 \times 2 = 982$), për çka të njëjtit për këtë kriter të kompensimit i takon shuma prej 982,00 euro.

Lidhur me kërkesën për shpenzimet e udhëtimit në punë, gjykata vendosi duke u bazuar në dispozitën e nenit 35 paragrafi 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse – ku punojnë, i paguhet shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Andaj bazuar në dispozitën e lartcekur, e duke u bazuar në provat e lartcekura dhe atë vërtetimet për ditët e prezencës në punë, vërtetimit të lëshuara nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve në Gjakovë si dhe nga Ekspertiza financiare e përpiluar nga eksperti i licencuar i gjykatës N.N, gjykata erdhi në përfundim së kërkesa e paditësit për këtë kompensim, duhet të i njëhej në shumën prej 558,60 euro, duke bërë përlllogaritjen si në vijim: $798,00 \times 70\% = 558,60$ euro.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë së precizuar si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se *“Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me shpenzimet udhëtimit si dhe për pagesën e ushqimit në punë

që ka pasur ndaj këtu paditësit, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, të njëjtit i takon edhe kamata e gjykuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit iu pranuan shpenzimet siç më poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë shume prej 104,00 euro, për ekspertizë financiare shumë prej 100,00 euro, si dhe për pjesëmarrje në tri seanca gjyqësore shumë prej 405,60 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 629,60 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.291/21, me 31 tetor 2022

GJYQTARI,
Durim BALAJ

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.